



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-3060/1 të datës 26.06.2023 kundër _____ gjykatës në _____, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-3060/1 të datës 26.06.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Nga një parashtruesi i njohur më datë 26.06.2023, është dorëzuar denoncim kundër _____ gjykatës në _____, për parregullsi dhe parregullsitë e procedurës së zhvilluar të falimentimit, me çka është formuar lënda me numër 12-3060/1, datë 26.06.2023.

Në denoncim, parashtruesi pretendon dyshimin për kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autorizimit të gjyqtarit të falimentimit në _____ dhe gjyqtarit në _____, kur janë zhvilluar procedurat e falimentimit dhe janë marrë vendimet gjyqësore.

Bëhet fjalë për anulimin e vendimit njëherë të miratuar për fitimin e statusit juridik të objektit të kundërligjshëm në procedurë falimentimi dhe miratimin e një vendimi të ri në kundërshtim me Ligjin për shlyerjen e detyrueshme të falimentimit dhe likuidimit.

Miratimi i vendimit të gjykatës është ankimuar _____ dhe është vepruar ashtu që nga _____ ankesa është refuzuar si e papranueshme. Bëhet me dije se kallëzim penal është parashtruar edhe në PTHP- Shkup.

KSHPK-së i është dorëzuar kallëzimit tashmë të dorëzuar nga i njëjti kërkues me pretendime të ngjashme dhe kundër të njëjtit gjyqtar, ku vihet në dukje kryerja e qëllimshme dhe e pakujdesshme e funksionit gjyqësor dhe një gabim profesional i kryer gjatë veprimit për çështjen _____.

KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë paraqitur edhe dëshmi.

Lidhur me pretendimet e theksuara në denoncim për pakënaqësi me vendimet gjyqësore të marra nga gjyqtari, dhe duke pasur parasysh faktin dhe në bazë të këqyrjes së dokumentit bashkëlidhur se e njëjta kërkesë i është dërguar edhe Këshillit Gjyqësor, KSHPK-ja ka përcaktuar se nuk kishte elemente për veprimin kompetent të saj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: P.B

Mirato: Mr. SH.S, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska